



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2023:114137

Datë: 21.03.2025

Numri i dokumentit: 07028071

P.nr.288/2024

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË - DEGA NË VUSHTRRI - Departamenti i përgjithshëm-Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Naim Rekalu, me zyrtaren ligjore Artta Jusufi, në çështjen penale kundër të pandehurit S.G nga Vushtrria, për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 nën paragrafi 1.4 të KPRK-së, dhe veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 paragrafi 1 të KPRK-së i ngarkuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë - Departamentit të Përgjithshëm PP.II.nr.693/2023 e datës 04.10.2023, pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor publik të mbajtur me datë 20.03.2025, në të cilin ishin të pranishëm prokurori i shtetit, i pandehuri dhe mbrojtësi i tij sipas detyrës zyrtare, në të njëjtën datë mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 21.03.2025 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri: S.G, nga babai S... dhe nëna S... mbiemri i vajzërisë së nënës ..., i lindur me datë ... në Mitrovicë, me vendbanim në rrugën “...” në Vushtrri, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ka të kryer shkollën e mesme, i pa martuar, i gjendjes së dobët ekonomike, me numër personal

SHPALLET FAJTOR

Sepse: Me datë 21.05.2023, rreth orës 04:00 në rrugën “...” në Vushtrri, përkatësisht në afërsi të hamamit të qytetit, i pandehuri me dashje dhe me qëllim të cenimit të dinjitetit të personit tjetër, i shkakton lëndime trupore të dëmtuarit Sh.B, në atë mënyrë që si pasojë e një mosmarrëveshje verbale të ndodhur aty për aty, fillimisht fjalosen e pastaj i njëjti me përdorimin e një mjeti të përshtatshëm për shkaktimin e lëndimit të rëndë trupor me një brisk me teh 8cm e godet në pjesën e poshtme të shpinës në anën e djathtë, të cilat lëndime bazuar në akt ekspertimin mjeko ligjor

të datës 31.05.2023 bëjnë pjesë në dëmtime të lehta trupore me pasoja të përkohshme shëndetësore.

Me çka ka kryer veprën penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 nën paragrafi 1.4 të KPRK-së.

Andaj, gjykata konform dispozitave të neneve 4, 7, 17, 38, 39, 40, 42, 44, 69, 70, 71 dhe 72 të KPRK-së, si dhe nenit 241, 242, 276, 287, 364, 449 dhe 450 të KPPK-së,

E G J Y K O N

I. ME DËNIM ME BURGIM EFEKTIV në kohëzgjatje prej 180 (njëqind e tetëdhjetë) ditëve, i cili dënim do të ekzekutohet në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

II. Koha e kaluar në arrest shtëpiak nga data 21.05.2023 e deri me datën 21.07.2023, llogaritet në dënimi ne shqiptuar.

III. Në bazë të nenit 44 të KPRK-së, dhe me pëlqimin e të pandehurit, dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 180 (njëqind e tetëdhjetë) ditëve, i zëvendësohet me dënim me gjobë në shumë 1600 (me fjalë: një mijë e gjashtëqind) euro, të cilin dënim i akuzuari është i obliguar ta paguaj me 5 këste të barabarta mujore, më së largu deri më datën 5 të muajit vijues, e ku kësti i parë duhet të paguhet në afat prej 15 ditëve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Nëse i akuzuari nuk e paguan këstin e parë brenda afatit të përcaktuar, mundësia për pagesën e dënimit me këste do të revokohet, dhe dënimi me gjobë do të ekzekutohet menjëherë, e në rast se i pandehuri nuk dëshiron ose nuk mund të paguajë gjobën, Gjykata do të veproj në bazë të nenit 43 paragrafi 3 të KPRK-së, ashtu që të njëjtit, dënimi me gjobë do t'i zëvendësohet me dënim me burgim duke llogaritur për çdo 20 (euro) gjobë të papaguar, me një (1) ditë burgim.

IV. DETYROHET i pandehuri që në emër të kompensimit të viktimave të krimit të paguajë shumën prej njëzetë euro (20€), si dhe në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej tridhjetë euro (30€), të gjitha këto në afat prej 15 ditësh prej ditës së marrjes së formës së prerë të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

V. HUDHET aktakuza e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë/Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr.693/2023 e datës 04.10.2023, dhe PUSHOHET procedura penale kundër të pandehurit S.G, dhe at vetëm sa i përket veprës penale nga pika II e aktakuzës, Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 paragrafi 1 të KPRK-së, pasi që prokurori i shtetit është tërhequr nga ndjekja penale sa i përket kësaj vepre penale para fillimit të shqyrtimit gjyqësor.

VI. Pala e dëmtuar Sh.B për realizmin e kërkesës pasurore-juridike, udhëzohet në kontest të rregullt civil.

A r s y e t i m

Pjesa hyrëse e aktgjykimit të arsyetuar

Prokuroria Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur aktakuzë PP.II.nr.693/2023 e datës 04.10.2023 kundër të pandehurit S.G nga Vushtrria, për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 nën paragrafi 1.4 të KPRK-së, dhe veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 paragrafi 1 të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit gjyqësor me datë 20.03.2025, në të cilën seancë ka prezantuar Prokurori i Shtetit Shaqir Sedolli, i pandehuri S.G së bashku me mbrojtësin e tij të caktuar sipas detyrës zyrtare av.Rifat Bllata.

Para leximit të aktakuzës, Prokurori i Shtetit është tërhequr nga ndjekja penale sa i përket veprës penale nga pika II e aktakuzës, Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 paragrafi 1 të KPRK-së, andaj gjykata në kuptim të nenit 287 par. 1 e në lidhje me nenin 320 par. 1 të KPPK-së, vendosi që të HUDHË aktakuzën e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë/Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr.693/2023 e datës 04.10.2023, dhe ta pushoj procedurën penale kundër të pandehurit S.G, dhe at vetëm sa i përket veprës penale nga pika II e aktakuzës, Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 paragrafi 1 të KPRK-së, pasi që prokurori i shtetit është tërhequr nga ndjekja penale sa i përket kësaj vepre penale para fillimit të shqyrtimit gjyqësor.

Pas leximit të aktakuzës, nga ana e Prokurorit të Shtetit, dhe pasi që gjykata është bindur se i pandehuri e ka kuptuar aktakuzën dhe veprën penale për të cilën akuzohet, Lëndim i lehtë trupor

nga neni 185 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 nën paragrafi 1.4 të KPRK-së, si dhe sqarimit të benifitieve dhe pasojave të pranimit të fajësisë, të njëjtit i është ofruar mundësia që të deklarohet lidhur me fajësinë. I pandehuri ka deklaruar se ndjehet fajtor për veprën penale që i vihet në barrë, i vjen keq për atë që ka ndodhur, kur ka ndodhur rasti e ka ndjerë vetën të frikësuar, i ka premtuar gjykatës së në të ardhmen nuk do ta përsëris vepra penale të kësaj natyre apo natyrave të tjera, është hera e parë që ka rënë ndesh me ligjin dhe që është para gjykatës, e po ashtu me palën e dëmtuar janë pajtuar dhe i ka kërkuar falje.

Prokurori i shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka deklaruar se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore për pranimin e fajësisë nga i akuzuari në drejtim të veprës penale të lartë shënuar, pasi që pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij, i bazuar në provat materiale si në aktakuzë si dhe i ka propozuar gjykatës që pranimin e fajësisë ta aprovoj.

Avokati mbrojtës lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka deklaruar se, pajtohet me pranimin e fajësisë nga i mbrojturi i tij, i cili u bë në mënyrë vullnetare, pa imponime apo ndikime dhe në konsultim edhe me të si mbrojtës i tij.

Gjykata duke vlerësuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka gjetur se, pranimi i fajësisë ishte në pajtim me nenin 242 par. 2 të KPPK-së pasi që, i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i pandehuri, se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, se aktakuza nuk përmban ndonjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Në kuptim të nenit 322 par. 4 të KPPK-së, pas aprovimit të pranimit të fajësisë nga ana e të pandehurit, gjykata ka kaluar në fjalën përfundimtare të palëve.

Prokurori i Shtetit në fjalën përfundimtare ka deklaruar se, pas aprovimit të fajësisë nga ana e gjykatës, në tërësi është vërtetuar gjendja faktike e përshkruar si në dispozitivin I të aktakuzës, andaj, gjykatës i ka propozuar që të pandehurin të shpall fajtor dhe ta dënoj sipas ligjit, gjatë matjes së dënimit të merr parasysh rrethanat lehtësuese dhe rënduese dhe atë si rrethana lehtësuese pranimin e fajësisë në shqyrtim gjyqësor, ndërsa si rrethana rënduese shkallën e përgjegjësisë penale, intensitetin e rrezikimit të vlerës së mbrojtur, që në këtë rast është trupi dhe jeta e njeriut, mënyrën dhe rrethanat kryerjes së veprës penale, si dhe gjykatës i ka kërkuar që të

verifikojë të kaluarën kriminale të të pandehurit dhe eventualisht ta merr si rrethanë rënduese apo lehtësuese.

Avokati mbrojtës i të pandehurit av. Rifat Bllata në fjalën përfundimtare ka deklaruar se, meqenëse i mbrojturi i tij e ka pranuar fajësinë në shqyrtim gjyqësor, dhe atë prokurori i shtetit është tërhequr nga pika II e dispozitivit të aktakuzës, e ka njoftuar gjykatën se i pandehuri është pajtuar sipas traditave me familjen B..., gjegjësisht me Sh..., A... dhe A... dhe atë një konfirmim i tillë ka ardhur edhe nga vendimi i kësaj gjykate P.nr.288/24, i datës 01.11.2024 kur e njëjta gjykatë ka aprovuar marrëveshjen e arritur te ndërmjetësuesi. I pandehuri ka rëndë ndesh me ligjin për herën e parë dhe pas kryerjes së kësaj veprën, nuk ka kryer vepra të tjera penale, i njëjti është mbajtës i familjes shumë anëtarëshe dhe prindërve të tij dhe nga të ardhurat të cilat i realizon nga puna e tij, e siguron ekzistencën e familjes, në fund i ka propozuar gjykatës që me rastin e caktimit të llojit të dënimit, të pandehurit ti shqiptoj një dënim me gjobë.

I pandehuri në fjalën përfundimtare ke deklaruar se, e përkrah fjalën e mbrojtësit të tij.

Faktet e çështjes në raport me provat që përmban aktakuza.

Gjykata ka konstatuar se pranimi i fajësisë është i mbështetur edhe në provat materiale të cilat mbështesin aktakuzën dhe atë: Akt ekspertimi mjeko ligjor me numër reference Mi-222/23 i datës 31.05.2023, Raporti i oficerit i datës 21.05.2023, Raport i shpejtë i datës 21.05.2023, Shënim zyrtar i hetuesit i datës 21.05.2023, 2 Shënime zyrtare të hetuesit të datës 22.05.2023 dhe 25.05.2023, procesverbal i marrjes në pyetje të dëmtuarit Sh.B në hetuesi me datë 21.05.2023, procesverbal i marrjes në pyetje të dyshuarit Sh.B në hetuesi me datë 23.05.2023, procesverbal i marrjes në pyetje të dëshmitarit-viktimës E.B në hetuesi me datë 21.05.2023, procesverbal i marrjes në pyetje të ankuesit A.B në hetuesi me datë 21.05.2023, raport mjekësor lëshuar nga Qendra Emergjente në Vushtrri në emër të Sh.B me numër rendor 5104, raport mjekësor lëshuar nga Qendra Emergjente në Vushtrri në emër të Sh.B me numër rendor 5087, raport mjekësor nga Klinika Emergjente në Prishtinë në emër të Sh.B me numër rendor 34025, fletëlëshim me epikrizë në emër të Sh.B me numër amzë 3407, raporte mjekësore lëshuar nga Qendra Emergjente në Vushtrri në emër të S.G me numër rendor 5090 dhe 5113, raport mjekësor nga Klinika Emergjente në Prishtinë në emër të S.G me numër rendor 34169, raport mjekësor lëshuar nga Qendra Emergjente në Vushtrri në emër të A.B me numër rendor 5088, raport mjekësor lëshuar nga Qendra Emergjente në Vushtrri në emër të B.H me numër rendor 5089, procesverbal

mbi dorëzimin vullnetar të video incizimeve, përmbajtja e dosjes së forenzikës, fotoalbumi dhe lista e dëshmvive, CD.

Gjetjet e gjykatës lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit

Për veprën penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 nën paragrafi 1.4 të KPRK-së, ligjvënësi ka paraparë mundësinë e shqiptimit të dënimit me burgim prej gjashtë (6) muaj, deri në pesë (5) vjet, e në këtë rast gjykata ndaj të akuzuarit për veprën penale nga pika I e dispozitivit të këtij aktgjykimi, vendosi që të shqiptoj dënim me burgim në kohëzgjatje prej njëqind e tetëdhjetë (180) ditëve, mirëpo konform nenit 44 të KPRK-së, me pëlqimin e të akuzuarit, dënimi me burgim njëqind e tetëdhjetë (180) ditëve, është zëvendësuar në dënim me gjobë në shumë prej njëmijë e gjashtëqind (1600) euro, të cilat dënime duhet të paguhen në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, e konform nenit 79 par. 1 të KPRK-së, dhe nenit 364 par. 2 nën par. 2.2 të KPPK-së, në dënimin e shqiptuar, është llogaritur edhe koha e kaluar në arrest shtëpiak nga data 21.05.2023 e deri me datën 21.07.2023.

Lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit gjykata ka pasur parasysh vlerësimin e rrethanave lehtësuese dhe rënduese për matjen e dënimit në mbështetje të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së. Si rrethana rënduese për të pandehurin ka gjetur, shkallën e përgjegjësisë penale dhe rrezikshmërinë shoqërore, ndërsa në kuadër të rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar pranimin e fajësisë, pendimin e tij për kryerjen e kësaj vepre penale, premtimin që i ka bërë gjykatës se nuk do të përsërisë vepra penale, më parë i pa gjykuar, dhe faktin se më të dëmtuarin i kishin rregulluar raportet dhe të njëjtit kanë marrëdhënie të mira.

Gjykata duke vlerësuar të gjitha këto rrethana ka gjetur se në rastin konkret, edhe me këto dënime të shqiptuara ndaj të pandehurit do të arrihet qëllimi i dënimit, që të parandalojë kryerësit nga kryerja e veprave tjera penale në të ardhmen, të bëjë rehabilitimin në rastin konkret, që i pandehuri në të ardhmen të ketë kujdes të shtuar, që të mos bien në kundërshtim me ligjin, t'i parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Gjykata, duke u bazuar në nenin 43 par. 2 të KPRK-së, në të cilin përcaktohet se *“Në aktgjykim caktohet afati i pagesës së dënimit me gjobë. Afati nuk mund të jetë më i shkurtër se pesëmbëdhjetë (15) ditë e as më i gjatë se tre (3) muaj, mirëpo në rrethana të arsyeshme gjykata mund të lejojë që dënimi me gjobë të paguhet me këste për një periudhë që nuk tejkalon dy (2)*

vjet. Aktgjykimi po ashtu duhet të përcaktojë se kur duhet të paguhen këstet dhe duhet të cek se mundësia e pagesës me këste do të revokohet nëse personi i dënuar nuk e paguan këstin me kohë”, ka lejuar që dënimi me gjobë në shumë prej 1600 (njëmijë e gjashtëqind) euro, të paguhet me këste mujore, dhe atë me 5 këste të barabarta, më së largu deri me datën 5 të muajit vijues, pasi që ka vlerësuar se në rastin konkret kemi rrethana të arsyeshme që dënimi me gjobë të paguhet edhe përtej afatit ligjor prej 3 (tre) muajve, pasi që gjendja ekonomike e të pandehurit paraqitet si rrethanë e arsyeshme për të zgjatur këtë afat, ngase i njëjti është i gjendjes së dobët ekonomike, dhe urdhërimi i pagimit të dënimit me gjobë brenda tre muajve, mund të rrezikoj sigurimin e ushqimit, kujdesit shëndetësor dhe nevojave të tjera bazë, apo mund të paraqitet si dënim i cili ka për qëllim zëvendësimin e të njëjtit në dënim me burgim.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale gjykata e ka marrë në bazë të nenit 449 par 2 nën par 2.6 dhe nenit 450 par. 1 të KPPK-së.

Vendimin për taksën e kompensimit të viktimave të krimit gjykata e ka marrë në bazë të nenit 6 paragrafi 1 pika 1.5 dhe nenin 39 par 3 pika 3.1 të Ligjit Nr. 05/L-36 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimin që palën e dëmtuar ta udhëzoj në kontest juridiko civil, gjykata e ka bazuar në nenin 462 par. 2 të KPPK-së.

Andaj, gjykata duke u bazuar në arsyet e lartshënuara ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTRRI

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal

P.nr.288/2024, datë 21.03.2025

Zyrtarja Ligjore

Arta Jusufi

G j y q t a r i

Naim Rekalio

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Kosovë, në afat prej tridhjetë (30) ditësh, llogaritur nga dita e pranimit të aktgjykimit. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe për gjykatën.